



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 131 Prot.

Tiranë, më datë 25.02.2022

**VENDIM**

**Nr.41, datë 25.02.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.02.2022:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për Raport i Vëzhgimit Arkeologjik dhe Koncepti i Sondazheve Arkeologjike i realizuar nga individ i licencuar në arkelogji Z. Taulant Rama, në kuader të projektit “Ndërtimi i rrjetit inxhinierik të tubacioneve fibrat optike & coax”, Bashkia Sarandë, me aplikues “Kle80Kle” sh.p.k. dhe zhvillues “I Click.al” sh.p.k.:
  - a. Të rishikohet linja e projektit brënda zonës arkeologjike “A” dhe “B”, e cila duhet të ndjekë linjat e infrastrukturës ekzistuese të qytetit, me qëllim minimizimin e impaktit në pjesën e nëntokës arkeologjike të qytetit të Sarandës;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarreveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrative.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

**Rudina ZOTO**

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

